



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 1014/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Selmans Netëork” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810815061 dhe seli në Prishtinë, rr. “Jakov Xoxa” Kompleksi Blini.Co. p.nr., duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 217/23, i lejuar më datë 14.06.2023, nga Përbaruesi Privat Ilmi Miftaraj, me seli në Mitrovicë, jashtë seancës me datë 30.10.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET, në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Selmans Netëork” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810815061, ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 217/23, i lejuar më datë 14.06.2023, nga Përbaruesi Privat Ilmi Miftaraj.
- II. Urdhri Përbarimor P.nr. 217/23, i lejuar më datë 14.06.2023, nga Përbaruesi Privat Ilmi Miftaraj, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të Kreditori, mbi bazën e dokumentit përbarimor; Vendimit Nr. 02V-43/23/1607, të datës 10.05.2023, ka lejuar urdhrin përbarimor P.nr. 217/23, me datë 14.06.2023, me të cilin është caktuar përbarimi dhe është urdhëruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, t’ia paguaj kreditorit shumën në lartësi prej EUR 1,000.00 ne emër të masës ndëshkimore, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përbarimor dhe ka theksuar se i njëjti nuk i përmban tiparet për përbarueshmëri, sipas nenit 21, 22, 27, 38, 40, 43, 46, 69 dhe 71 të LPP-së. Me tej, ka theksuar përbaruesi privat ka nxjerr urdhër mbi lejimin e propozimit për iniciimin e procedurës përbarimore për

një çështje që nuk është kompetencë e tij për vendosje, e që është kompetencë e gjykatës. Në fund ka shtuar se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk i është dorëzuar asnjëherë debitorit dhe në këtë mënyrë i është pamundësuar kundërshtimi i të njëjtit, andaj ky vendim nuk është i përshtatshëm për përmbartim. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit, ashtu që urdhri përmbartimor të anulohet, ndërsa procedura përmbartimore të përfundohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit dhe ka theksuar se urdhri i kontestuar është në përputhje të plotë me dispozita ligjore nga LPP. Tutje, ka shtuar se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbartimor i është dorëzuar debitorit përmes postës me nr. R-2892535, dhe ndaj të njëjtit nuk ka paraqitur ankesë. Në fund ka theksuar se konform Ligjit nr. 2002/9 dhe nr. 03/L-17 për inspektoratin e punës, ankesa e paraqitur nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit të inspektoratit. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor përkatësisht vendimin mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata vlerëson se vendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në kuptim të nenit 27 paragrafin 1, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Po ashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimin Nr. 02V-43/23/1607, i datës 10.05.2023, mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, i cili është bërë i

plotfuqishëm dhe mban vulën e ekzekutueshmërisë së datës 23.05.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36, paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: “Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”, dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: “Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”.

Gjykata, ka vlerësuar pretendimet e debitorit i cili ka theksuar vendimi i shkallës së parë nuk i është dorëzuar asnjëherë debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pabazuara, ngase nga fletë kthesa e postës e cila gjendet në shkresa të lëndës, vërtetohet se me datë 12.05.2023 debitori ka pranuar vendimin mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbarimor, i cili vendim ka marr formë të prerë dhe është bërë i ekzekutueshëm me datë 23.05.2023 dhe rrjedhimisht është i përshtatshëm për përmbarim.

Në këtë drejtim, gjykata gjen se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit u vendos jashtë seancës.

Nga sa më sipër, bazuar duke u bazuar në 73, paragrafi 1 dhe 3, të LPP-së, si dhe nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1014/23, datë 30.10.2023

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.